VENDIM
Nr. 711, datë 20.11.2024

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR MARRËDHËNIET E AVOKATURËS SË SHTETIT DHE PERSONAVE JURIDIKË, NË KUADËR TË OFRIMIT TË ASISTENCËS JURIDIKE, ROLIN E AVOKATËVE TË SHTETIT NË GJYKIM, SI DHE NORMAT E POSAÇME PROCEDURALE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 7, e 12, pikat 2 e 6, të ligjit nr. 10 018, datë 13.11.2008, "Për Avokaturën e Shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores "Për marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit dhe personave juridikë, në kuadër të ofrimit të asistencës juridike, rolin e avokatëve të shtetit në gjykim, si dhe normat e posaçme procedurale", sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Vendimi nr. 392, datë 8.4.2009, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores 'Për marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me institucionet shtetërore dhe entet publike, rolin e avokatëve të shtetit në gjykim, si dhe normat e posaçme procedurale', i ndryshuar", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

RREGULLORE
PËR MARRËDHËNIET E AVOKATURËS SË SHTETIT DHE PERSONAVE JURIDIKË, NË KUADËR TË OFRIMIT TË ASISTENCËS JURIDIKE, ROLIN E AVOKATËVE TË SHTETIT NË GJYKIM, SI DHE NORMAT E POSAÇME PROCEDURALE

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i rregullores

Kjo rregullore përcakton rregullat për:

a) marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me personat juridikë, të parashikuar në pikën 1/1, të nenit 5, të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008, "Për Avokaturën e Shtetit", të ndryshuar (në vijim "personat juridikë");

b) rastet dhe çështjet e ushtrimit të funksionit të përfaqësimit dhe të mbrojtjes në gjyq të avokatëve të shtetit pranë personave juridikë, për procedurat e posaçme për ushtrimin e aktivitetit të avokatëve të shtetit, rolin e avokatëve të shtetit në gjykim, si dhe normat e posaçme procedurale;

c) marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me personat juridikë publikë në kuadër të këshillimit;

ç) kriteret lëndore dhe sasiore për delegimin e së drejtës së përfaqësimit dhe të mbrojtjes nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit te personi juridik i interesuar;

d) mënyrën e bashkërendimit të punës së avokatëve të shtetit me personat juridikë, të cilëve u ofrohet asistenca juridike, si dhe raportet ndërmjet Avokaturës së Shtetit dhe titullarëve të institucioneve;

dh) marrëdhënien e bashkëpunimit me institucionet, të cilët detyrohen t'i vijnë në ndihmë avokatit të shtetit, në kuadër të ofrimit të asistencës juridike;

e) çështjet ekonomike dhe shpenzimet e procesit.

Neni 2
Parimet e bashkëpunimit

1. Strukturat e Avokaturës së Shtetit, në kuadër të bashkëpunimit, garantojnë zbatimin me përgjegjësi dhe korrektësi të legjislacionit në fuqi, njësimin e praktikës juridike dhe unitetin e doktrinës, pavarësinë profesionale dhe autonominë teknike, si dhe këshillimin e drejtë, mbrojtjen dhe përfaqësimin sa më të mirë të interesave publikë.

2. Avokatura e Shtetit gjatë bashkëpunimit udhëhiqet nga parimet e ekskluzivitetit, profesionalizmit, eficiencës, përgjegjësisë në zbatimin e ligjit, si dhe konfidencialitetit.

Neni 3
Dhënia e asistencës juridike

Avokatura e Shtetit jep ekskluzivisht asistencë juridike në formën e këshillimit dhe të përfaqësimit në gjykata për personat juridikë nëpërmjet:

a) ofrimit të shërbimit këshillimor, sipas parashikimeve ligjore;

b) përfaqësimit dhe mbrojtjes së interesave pasurorë në gjykatat kombëtare, ndërkombëtare e të huaja dhe arbitrazhin ndërkombëtar në të gjitha shkallët e gjykimit;

c) mbrojtjes së interesave pasurorë të shtetit nëpërmjet ngritjes së padisë civile në procesin penal;

ç) unifikimit të praktikës juridike;

d) ndërmjetësimit për zgjidhjen me pajtim të mosmarrëveshjeve, ndërmjet organeve qendrore të administratës publike dhe enteve publike;

dh) ngritjes së padisë për shpërblimin e dëmit;

e) ndërmarrjes së veprimeve për shfuqizimin e akteve juridike dhe kontratave administrative, nëpërmjet autorizimit paraprak nga personi juridik, me përjashtim të rasteve të urgjencës;

ë) paraqitjes së kërkesës për rishikimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

Neni 4
Refuzimi i dhënies së asistencës juridike

1. Avokatura e Shtetit nuk jep asistencë juridike, në rastet e mëposhtme:

a) në çështjet gjyqësore, ndërmjet organeve qendrore të administratës publike;

b) në çështjet gjyqësore, ndërmjet organeve të qeverisjes vendore, kur asistenca juridike ofrohet sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara në ligj ose në marrëveshje të posaçme midis Avokaturës së Shtetit dhe organeve të qeverisjes vendore;

c) në çështjet gjyqësore, ndërmjet organeve qendrore të administratës publike dhe organeve të qeverisjes vendore për organet e qeverisjes vendore, pavarësisht, nëse ndërmjet Avokaturës së Shtetit dhe organeve vendore mund të ketë një marrëveshje të posaçme për ofrimin e asistencës juridike;

ç) për hartimin e akteve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të së drejtës publike dhe çështjeve gjyqësore, që lidhen me këto procese, përveç kur parashikohet ndryshe në ligj;

d) në çështjet gjyqësore, në të cilat mosmarrëveshja është midis palëve private, pavarësisht, nëse palë ndërgjyqëse është edhe një person juridik publik.

2. Avokatura e Shtetit, kur konstaton se gjendet në një prej rasteve të ndaluara, njofton menjëherë organin procedues dhe personin juridik publik, që ka kërkuar asistencë juridike, me qëllim marrjen e masave të mëtejshme për garantimin e të drejtës së mbrojtjes.

Neni 5

Bashkërendimi i punës së Avokaturës së Shtetit me personat juridikë

1. Çdo person juridik, të cilit i ofrohet shërbimi i përfaqësimit nga Avokatura e Shtetit, duhet të ofrojë bashkëpunimin që do të kërkohet për të bërë efektiv funksionin e avokatëve të shtetit, duke siguruar njëkohësisht respektimin e afateve ligjore apo të afateve të caktuara nga organet përkatëse për kryerjen e veprimeve procedurale.

2. Detyrimi për bashkëpunim përfshin kryesisht, por pa u kufizuar, vënien në dispozicion të dokumentacionit, sqarimeve dhe informacioneve të nevojshme për shqyrtimin e çështjes, hartimin e raporteve lidhur me aktet ose veprimet që cenojnë interesat e personave juridikë, të asistuar nga Avokatura e Shtetit.

3. Personi juridik është i detyruar, që brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e depozitimit të kërkesës pranë institucionit, t'i përcjellë Avokaturës së Shtetit të gjitha sqarimet, informacionet dhe dokumentet e kërkuara.

4. Çdo person juridik, i cili merr asistencë juridike nga Avokatura e Shtetit, cakton një punonjës, si person kontakti, përgjegjës për shkëmbimin e informacionit dhe dokumentacionit me Avokaturën e Shtetit. Nëse personi juridik është i organizuar me zyra qendrore dhe vendore, cakton person kontakti në secilin nivel organizimi.

5. Për ata persona juridikë, që kanë në strukturën e tyre drejtori apo sektor të posaçëm, që mbulojnë përfaqësimin në gjykatë, person kontakti, sipas rastit, do të jetë drejtuesi ose përgjegjësi i kësaj strukture. Nëse personi juridik nuk ka në strukturën juridike një pozicion të tillë, titullari emëron, si person kontakti, një nëpunës të profilit jurist, i cili është i ngarkuar me përfaqësimin në gjykatë të institucionit.

6. Titullari i çdo personi juridik i njofton zyrtarisht me shkresë Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, të dhënat e kontaktit të personit ose personave të caktuar, si person kontakti, për mbajtjen e marrëdhënies me Avokaturën e Shtetit, në varësi të formës së organizimit.

7. Personi i kontaktit për Avokaturën e Shtetit pranë personave juridikë është përgjegjës dhe ka detyrimin të bashkëpunojë me avokatin e shtetit të caktuar për dhënien e asistencës juridike pranë atij institucioni, me qëllim sigurimin e dhënies së asistencës juridike në interesin më të lartë të shtetit.

8. Personi i kontaktit zhvillon takime pune, të paktën një herë në muaj, me avokatin e shtetit për koordinimin dhe diskutimin e çështjeve, të cilat paraqesin interes të veçantë. Me kërkesë të avokatit të shtetit, mund të zhvillohen takime pune, sa herë që del e nevojshme.

9. Në rast se avokati i shtetit vlerëson se afatet ligjore, procedurale apo ato të vendosura nga gjykata diktojnë urgjencë, përveç komunikimit shkresor, si më sipër, kontakton menjëherë në rrugë elektronike me personin e kontaktit të personit juridik, që do të përfaqësohet në gjykatë, duke i sqaruar nevojën dhe urgjencën, si dhe duke i kërkuar përcjelljen elektronike të të gjitha dokumenteve, informacioneve apo sqarimeve të nevojshme, brenda afatit të caktuar.

10. Për veprimet procedurale të ngutshme, për të cilat ka ardhur në dijeni përfaqësuesi ligjor i personit juridik apo është njoftuar nga Avokati i Shtetit, ka detyrimin që menjëherë dhe jo më vonë se 2 (dy) ditë kalendarike, të njoftojë Avokaturën e Shtetit dhe të dërgojë materialet e nevojshme për realizimin e përfaqësimit dhe mbrojtjes.

11. Personi juridik për çdo çështje gjyqësore, për të cilën përfaqësohet nga Avokatura e Shtetit, i dërgon kësaj të fundit, së bashku me dokumentet e kërkuara si më sipër, edhe një raport të hollësishëm për gjendjen e fakteve, të ligjit, si dhe qëndrimin zyrtar të institucionit për çështjen konkrete.

12. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit njofton titullarin e personit juridik për shkeljen e detyrimeve të parashikuara në këtë rregullore.

13. Mosrespektimi i afateve, të përcaktuara në këtë rregullore, në lidhje me bashkërendimin e punës nga ana e personave juridikë, që u ofrohet asistencë juridike apo institucionet e tjera që duhet të ofrojnë shërbime, informacione, dokumentacion apo sqarime në ndihmë të funksioneve

të Avokaturës së Shtetit, pa shkaqe të arsyeshme, apo krijimi i qëllimshëm i pengesave për shkeljen e tyre, përbën shkak për marrjen, sipas rastit, të masave disiplinore, masave administrative, civile dhe penale ndaj personave përgjegjës.

14. Në rast se nga personat juridikë nuk respektohet detyrimi për bashkëpunim, Avokatura e Shtetit njofton Kryeministrin.

KREU II
MARRËDHËNIET E AVOKATURËS SË SHTETIT ME PERSONAT JURIDIKË, NË KUADËR TË PËRFAQËSIMIT DHE MBROJTJES NË GJYKIM

Neni 6
Rastet dhe çështjet e ushtrimit të funksionit të përfaqësimit dhe të mbrojtjes në gjyq nga Avokatura e Shtetit

Avokatura e Shtetit kryen funksionet e mëposhtme:

a) Përfaqëson ekskluzivisht personat juridikë, të përcaktuar në pikën 1/1, të nenit 5, të ligjit nr. 10 018, datë 13.11.2008, "Për Avokaturën e Shtetit", të ndryshuar, pranë gjykatave kombëtare, ndërkombëtare dhe të huaja, pa autorizim të posaçëm të të përfaqësuarit në çështjet gjyqësore, në të cilat një organ i administratës shtetërore ose Republika e Shqipërisë është palë;

b) U jep mendim të specializuar organeve të administratës shtetërore dhe enteve publike, kur i kërkohet prej tyre;

c) Ndërmjetëson zgjidhje me marrëveshje të konflikteve, që lindin ndërmjet organeve qendrore të administratës publike dhe enteve publike, të parashikuara në pikën 1/1, të nenit 5, të ligjit nr. 10 018, datë 13.11.2008, "Për Avokaturën e Shtetit", të ndryshuar, kur kjo kërkohet nga palët;

ç) Ka të drejtën e nisjes së veprimeve ligjore, me qëllim për të shfuqizuar aktet juridike dhe kontratat administrative, si edhe për rishikimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, në përputhje me kushtet dhe kriteret e parashikuara në ligjin procedural dhe në ligjin nr. 10 018, datë 13.11.2008, "Për Avokaturën e Shtetit", të ndryshuar, me autorizim paraprak të organit administrativ të interesuar, me përjashtim të rasteve të urgjencës;

d) Ka të drejtë të ngrejë padi, me objekt shpërblimin e dëmit të shkaktuar interesave pasurorë të shtetit, me autorizimin e organit shtetëror përkatës, me përjashtim të rasteve të urgjencës;

dh) Ka të drejtë të bëjë kërkesë për rishikim vendimi gjyqësor të formës së prerë për çështje që ka interes pasuror shteti shqiptar;

e) Ka të drejtë të bëjë kërkesa në Gjykatën Kushtetuese, në bazë të një autorizimi të posaçëm dhe në përputhje me normat ligjore në fuqi.

Neni 7
Procedura e përfaqësimit

1. Në rastet e përfaqësimit dhe mbrojtjes së interesave të shtetit në gjykim, Avokatura e Shtetit zbaton legjislacionin në fuqi dhe rregullat e përcaktuara në këtë rregullore në çështjet gjyqësore, në të cilat një organ i administratës shtetërore ose Republika e Shqipërisë është palë. Në këto raste, Avokatura e Shtetit respekton rregullat për marrjen e kërkesës së motivuar nga organi i interesuar për t'u përfaqësuar në gjykim, pa qenë e nevojshme marrja e një autorizimi të posaçëm të të përfaqësuarit.

2. Avokatura e Shtetit mund të kryejë procedura të ndryshme nga ato të përcaktuara në këtë rregullore, kur është në interes të zgjidhjes së çështjes, objekt gjykimi, dhe me miratim të personit juridik të interesuar, por gjithmonë duke respektuar dispozitat ligjore procedurale.

3. Në çdo rast, Avokatura e Shtetit, në përpilimin e akteve drejtuar organeve gjyqësore, respekton kërkesat formale të legjislacionit procedural.

Neni 8

Kriteret lëndore dhe sasiore për delegimin e të drejtës së përfaqësimit dhe të mbrojtjes

1. Delegimi i të drejtës së përfaqësimit në gjykim nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit bëhet bazuar në kriteret e mëposhtme, kur:

a) vlera e objektit të padisë së çështjes objekt gjykimi është më e vogël se 2 (dy) milionë lekë;

b) objekt gjykimi janë marrëdhëniet e punës ndërmjet institucioneve dhe personave të tretë, pavarësisht, shkronjës "a" të kësaj pike;

c) në rastet e mbrojtjes së interesave pasurorë të shtetit në gjykimin penal, vlera e dëmit material është më e vogël se 2 (dy) milionë lekë;

ç) sipas statistikave, ka një numër të konsiderueshëm çështjesh të ngjashme nga i njëjti institucion dhe praktika juridike është njësuar;

d) objekt mosmarrëveshjeje është konflikti midis palëve private, pavarësisht, nëse palë ndërgjyqëse është një institucion shtetëror;

dh) objekt i mosmarrëveshjes janë akte administrative, pa vlerë financiare.

2. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, kur vlerëson se delegimi i së drejtës së përfaqësimit është i mundshëm, në bazë të kritereve të njësimit të praktikës nga Avokatura e Shtetit dhe/ose për çështje me karakter të veçantë, ka të drejtë të vendosë delegimin e përfaqësimit në gjykim.

Neni 9

Delegimi i përfaqësimit dhe i mbrojtjes

1. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, kryesisht ose nëpërmjet Kolegjit të Avokaturës së Shtetit, të caktuar për përfaqësimin e një çështjeje, mund ta delegojë të drejtën e përfaqësimit të interesave të shtetit në gjykim te personi juridik i interesuar.

2. Për çështjet që janë deleguar me urdhër të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, avokati i shtetit njofton gjykatën për delegimin e çështjes. Këtë njoftim, avokati i shtetit e përcjell në rrugë elektronike, brenda ditës edhe te personi i kontaktit të personit juridik për Avokaturën e Shtetit.

3. Kur gjatë gjykimit, nga ana e përfaqësuesit të personit juridik konstatohet se, ka ndryshuar objekti i mosmarrëveshjes gjyqësore ose pozita procedurale e palëve dhe çmohet i nevojshëm përfaqësimi nga Avokatura e Shtetit, duhet të njoftojë me shkrim dhe në rrugë elektronike nëpërmjet personit të kontaktit, për marrjen e masave për përfaqësimin në gjykim. Për këtë rast, Avokatura e Shtetit ka të drejtën të shprehet për pranimin ose jo të kërkesës, brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga paraqitja e saj, nëpërmjet postës elektronike.

4. Pavarësisht delegimit të përfaqësimit dhe mbrojtjes së çështjes te personi juridik i interesuar, hartimi i rekursit dhe përfaqësimi në Gjykatën e Lartë do të bëhet nga Avokatura e Shtetit, pas kërkesës së bërë nga personi juridik.

5. Për çështjet që janë deleguar dhe që Avokatura e Shtetit nuk ka marrë pjesë në gjykim përfaqësuesit ligjorë të personave juridikë duhet të përcjellin qëndrimin me shkrim dhe informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm pranë Avokaturës së Shtetit, në mënyrë që të ushtrohet e drejta e rekursit në Gjykatën e Lartë.

Neni 10

Detyrimi i pranimit të delegimit

Personi juridik, të cilit i delegohet e drejta e përfaqësimit të interesave të shtetit në gjykim, nuk mund ta refuzojë përfaqësimin dhe mbrojtjen për çështjen e deleguar, me përjashtim të rasteve të konfliktit të interesit. Konflikti i interesit për përfaqësim i njoftohet menjëherë me shkrim Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit.

Neni 11

Detyrimi për unifikimin e qëndrimit në përfaqësimin ligjor të personave juridikë

1. Personat juridikë, për të cilët Avokatura e Shtetit ofron asistencë juridike, kanë detyrimin për t'i njoftuar avokatit të shtetit, të caktuar për përfaqësimin në gjykim, qëndrimin e tyre me shkrim dhe provat, brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga njoftimi i kërkesës për gjykim apo fillimi i afatit për paraqitjen e akteve në gjykatë.

2. Në çështjet gjyqësore, në të cilat Avokatura e Shtetit ofron asistencë juridike sipas ligjit, personat juridikë publikë kanë detyrimin të unifikojnë qëndrimin dhe strategjinë e mbrojtjes me avokatin e shtetit, të caktuar për ndjekjen e çështjes.

3. Në rastet kur avokati i shtetit konstaton moszbatimin e kësaj dispozite, njofton menjëherë Avokatin e Përgjithshëm të Shtetit dhe titullarin e personit juridik që përfaqësohet, për marrjen e masave, sipas pikave 12, 13 dhe 14, të nenit 5, të kësaj rregulloreje.

4. Përfaqësuesit ligjorë të personave juridikë nuk duhet të depozitojnë akte në gjykatë, të cilat janë të ndryshme nga qëndrimi i mbajtur nga Avokatura e Shtetit, me përjashtim të rasteve kur janë palë kundërshtare në gjykim. Për çdo rast, personat juridikë, përpara depozitimit të akteve duhet të konsultohen me avokatin e shtetit, të caktuar për ndjekjen e çështjes.

Neni 12
Përfaqësimi

1. Interesat pasurorë të shtetit shqiptar pranë gjykatave kombëtare, ndërkombëtare dhe të huaja, si dhe organeve të tjera në çështjet gjyqësore, në të cilat një institucion shtetëror, ent publik ose Republika e Shqipërisë është palë, përfaqësohen dhe mbrohen nga Avokatura e Shtetit.

2. Zyra e përfaqësimit në gjykatat e huaja, ndërkombëtare dhe në arbitrazhin ndërkombëtar, në nivelin qendror të Avokaturës së Shtetit, përfaqëson dhe mbron interesat e shtetit shqiptar pranë gjykatave të huaja dhe organizmave ndërkombëtarë, me karakter gjyqësor apo mbikëqyrës.

3. Zyra e përfaqësimit ligjor në gjykatat kombëtare, në nivelin qendror në Avokaturën e Shtetit, përfaqëson dhe mbron interesat pasurorë të shtetit në Gjykatën e Lartë dhe në Gjykatën Kushtetuese.

4. Avokatët e shtetit pranë ministrive përfaqësojnë dhe mbrojnë interesat e shtetit në gjykatat e shkallës së parë dhe në gjykatat e apelit në çështjet gjyqësore, të cilat kanë për objekt:

a) mbrojtjen e interesave pasurorë të ministrive;

b) mbrojtjen e interesave pasurorë të institucioneve në varësi të ministrive.

5. Zyrat vendore të Avokaturës së Shtetit mbrojnë dhe përfaqësojnë interesat pasurorë të shtetit në gjykatat e shkallës së parë dhe në gjykatat e apelit, sipas organizimit territorial dhe kompetencave tokësore, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 13
Përfaqësimi në gjykatat e shkallës së parë dhe në gjykatat e apelit

1. Për çështjet gjyqësore, në të cilat Avokatura e Shtetit përfaqëson dhe mbron interesat e personave juridikë, gëzon ekskluzivitetin për të vendosur për mënyrën dhe strategjinë e mbrojtjes.

2. Avokatura e Shtetit ka të drejtë të paraqesë në gjykim çdo lloj kërkese, sipas ligjit, që shërben për realizimin e një mbrojtjeje efektive, përfshirë kundërpadi, kërkesa për pezullim, kompetencë dhe juridiksion. Në rastin e paraqitjes së kundërpadisë, personi juridik, të cilit i ofrohet asistenca juridike, duhet të pajisë Avokaturën e Shtetit me autorizimin përkatës, brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga dita e depozitimit në gjykatë.

3. Përfaqësuesit ligjorë të personave juridikë duhet t'i njoftojnë Avokaturës së Shtetit, qëndrimin e tyre me shkrim, jo më vonë se 5 (pesë) ditë kalendarike nga komunikimi i akteve nga gjykata.

4. Përfaqësuesit e personit juridik, në rastet kur marrin pjesë në gjykim, përpara se të paraqesin çdo lloj akti përfaqësimi në gjykatë, duhet të konsultohen më parë me avokatin e shtetit, që ka në ndjekje çështjen gjyqësore, dhe vetëm pas miratimit të strategjisë së mbrojtjes kanë të drejtë të paraqesin akte në gjykatë. Miratimi i strategjisë së mbrojtjes mund të jepet nëpërmjet postës elektronike dhe jo më vonë se 2 (dy) ditë pune nga përfundimi i afatit të depozitimit të mbrojtjes.

5. Të gjitha aktet procedurale, që do të paraqiten në gjykatë, duhet të jenë të koordinuara dhe qëndrimi i përfaqësuesve ligjorë të personave juridikë duhet të jetë i njëjtë me qëndrimin dhe mbrojtjen e Avokatit të Shtetit, i cili ka të drejtë të ndërhyjë në çdo kohë në qëndrimin e personit juridik publik, me qëllim unifikimin e strategjisë së mbrojtjes.

Neni 14
Paraqitja e rekursit

1. Avokatura e Shtetit paraqet rekurs në Gjykatën e Lartë për të gjitha çështjet gjyqësore, në të cilat ka ushtruar përfaqësim ligjor në shkallët e mëparshme të gjykimit apo që ushtron përfaqësim, sipas ligjit.

2. Për çështjet gjyqësore, për të cilat Avokatura e Shtetit ka deleguar të drejtën e përfaqësimit, dhe nga ana e personave juridikë çmohet se duhet ushtruar e drejta e rekursit, përgatitja, nënshkrimi dhe depozitimi i tij do të kryhen nga Avokatura e Shtetit, e asistuar nga përfaqësuesit e personave juridikë, të cilët duhet të paraqesin qëndrimin e arsyetuar për shkaqet e ushtrimit të rekursit, sipas ligjit.

3. Për çështjet gjyqësore, ku Avokatura e Shtetit ka refuzuar të drejtën e përfaqësimit, sipas përcaktimeve në pikën 2, të nenit 5, të ligjit nr. 10 018, datë 13.11.2008, "Për Avokaturën e Shtetit", të ndryshuar, nuk do të ofrohet asistenca juridike nga ana e Avokaturës së Shtetit.

4. Për realizimin e përfaqësimit dhe të mbrojtjes efektive, personat juridikë duhet të ofrojnë bashkëpunimin dhe ndihmën e tyre, në kuadër të dërgimit të të gjithë informacionit dhe dokumentacionit për çështjet gjyqësore, brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga momenti i njoftimit dhe 3 (tri) ditë kalendarike për rastet e rekurseve të veçanta.

5. Rekursi, për çdo rast, nënshkruhet nga Avokatura e Shtetit, pa qenë nevoja e nënshkrimit të tij nga personi juridik që përfaqësohet, i cili mund të nënshkruajë në rekurs, nëse e kërkon shprehimisht me shkrim.

6. Personi juridik ka të drejtën të shprehet për mosparaqitjen e rekursit, por në çdo rast, qëndrimi duhet të jetë i arsyetuar dhe me shkrim dhe t'i njoftohet Avokaturës së Shtetit, brenda 5 (pesë) ditëve nga njoftimi i vendimit.

7. Në rastet kur personi juridik shprehet për mosparaqitjen e rekursit ose heqjen dorë nga rekursi, ky qëndrim i njoftohet zyrtarisht Avokaturës së Shtetit. Avokatura e Shtetit, pasi vlerëson situatën ligjore, vendos për kërkesën për mosushtrimin ose heqjen dorë nga e drejta e rekursit.

Neni 15
Përfaqësimi në Gjykatën e Lartë

1. Avokatura e Shtetit përfaqëson dhe mbron interesat pasurorë të shtetit në Gjykatën e Lartë dhe në Gjykatën Kushtetuese, sipas ligjit.

2. Për rastet, kur Gjykata e Lartë njofton personin juridik drejtpërdrejt apo nëpërmjet Avokaturës së Shtetit, për kthimin e rekursit për plotësimin e të metave, sipas neneve 474 dhe 476, të Kodit të Procedurës Civile, personi juridik përkatës është i detyruar të njoftojë menjëherë Avokaturën e Shtetit, në rrugë elektronike, nëpërmjet *e-mail*-it zyrtar drejtuar personit të kontaktit, dhe në rrugë shkresore drejtuar Avokaturës së Shtetit.

Neni 16
Paraqitja e ankimit kushtetues individual

1. Në rastet kur çmohet se ka shkaqe të ligjshme për të paraqitur ankim individual pranë Gjykatës Kushtetuese, Avokatura e Shtetit njofton personin juridik, brenda një periudhe prej 2 (dy) muajve nga dhënia e vendimit, për dhënien e mendimit me shkrim.

2. Pas dhënies së mendimit me shkrim, nga ana e Avokaturës së Shtetit dërgohet kërkesa për dhënien e autorizimit, e cila përmban shkaqet ligjore për paraqitjen e ankimit kushtetues ndaj vendimit gjyqësor.

3. Personi juridik, brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga njoftimi i kërkesës për dhënie autorizimi, ka të drejtën për dhënien e autorizimit përkatës.

Neni 17

Roli i avokatit të shtetit në gjykim dhe marrëdhënia me personin juridik

1. Avokatët e shtetit, gjatë përfaqësimit të institucioneve shtetërore, mbrojnë interesat e institucionit që përfaqësojnë dhe interesat pasurorë të shtetit, gjatë të gjitha fazave procedurale që marrin pjesë.

2. Në çështjet gjyqësore, në të cilat Avokatura e Shtetit ushtron përfaqësimin për institucionin, përfaqësuesi ligjor i këtij të fundit, i ngarkuar me ndjekjen e çështjes, bashkëpunon në mënyrë të ngushtë me avokatin e shtetit.

3. Avokatët e shtetit kanë funksion përfaqësues dhe mbrojtës të personit juridik dhe përfaqësuesit ligjorë të personave juridikë bashkëpunojnë dhe ndihmojnë në dhënien e informacionit dhe shprehjes së vullnetit të institucionit që përfaqësojnë.

KREU III

MARRËDHËNIET E AVOKATURËS SË SHTETIT ME PERSONAT JURIDIKË, NË KUADËR TË NGRITJES SË PADISË

Neni 18

Nisma për fillimin e procedurave administrative dhe ligjore

1. Avokatura e Shtetit ka të drejtë të fillojë procedurat për paraqitjen e kërkesëpadisë, të kundërpadisë, të kërkesës për rishikim vendimi gjyqësor të formës së prerë apo çdo veprimi procedural të ngjashëm, kryesisht ose me kërkesë me shkrim të motivuar të personit juridik ose entit publik të interesuar, me përjashtim të rasteve urgjente.

2. Avokatura e Shtetit, sipas kërkesës së motivuar dhe autorizimit të personit juridik të interesuar, ka të drejtë të fillojë procedurat për ngritjen e padisë, me objekt pavlefshmërinë e veprimit juridik, që tjetërson ose disponon mbi pasurinë shtetërore, në favor të të tretëve ose për shpërblimin e dëmit të shkaktuar interesave pasurorë të shtetit ose pavlefshmëri të kontratave administrative, të lidhura me të tretë ose me çdo objekt tjetër për mbrojtjen e interesave pasurorë të shtetit.

3. Avokatura e Shtetit, përpara depozitimit të padisë në gjykatë, i paraqet personit juridik të interesuar një raport të hollësishëm me shkrim për gjendjen e fakteve dhe të ligjit, kostot e pritshme të gjykimit, si dhe për çdo shpenzim të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm apo çdo dëmshpërblim pasuror dhe jopasuror, që pala tjetër mund të pretendojë ose të fitojë gjatë apo pas përfundimit të gjykimit për shpalljen e pavlefshme të kontratës ose të veprimit juridik. Ky raport mbyllet me qëndrimin e shprehur të Avokaturës së Shtetit për ngritjen ose jo të padisë.

4. Në rastet urgjente, Avokatura e Shtetit njofton menjëherë personin juridik të interesuar dhe brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga fillimi i procedurave administrative apo gjyqësore i paraqet raportin e hollësishëm sipas pikës 3 të këtij neni. Personi juridik i interesuar, me marrjen e njoftimit dhe të raportit të hollësishëm, miraton veprimet e kryera dhe jep autorizimin me shkrim për vazhdimin ose jo të procedurës së filluar.

5. Në rast se personi juridik fillon procedurat ankimuese administrative apo gjyqësore me nismën e vet, nëpërmjet padisë apo ankimit, atëherë ai ka detyrimin për të njoftuar paraprakisht me shkrim Avokaturën e Shtetit dhe për të marrë një vlerësim ligjor për hartimin e aktit dhe strategjinë e mbrojtjes.

KREU IV
MARRËDHËNIET E AVOKATURËS SË SHTETIT ME PERSONAT JURIDIKË, NË KUADËR TË KËSHILLIMIT

Neni 19
Rastet e ushtrimit të funksioneve këshillimore nga Avokatura e Shtetit

1. Personat juridikë, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, në përputhje me parashikimet ligjore, mund të kërkojnë nga Avokatura e Shtetit mendim me shkrim për çështje të karakterit juridik, të cilat mund të prodhojnë pasoja financiare për shtetin.

2. Personat juridikë mund të kërkojnë paraprakisht nga Avokatura e Shtetit mendim për projektet e kontratave, të cilat do të nënshkruhen prej tyre. Në këtë rast, Avokatura e Shtetit mund të sugjerojë paraprakisht përmbajtjen e tyre.

3. Këshillimi paraprak i personit juridik me Avokaturën e Shtetit është i detyrueshëm për t'u kërkuar, në rastet e mëposhtme:

a) Për hartimin, negocimin nënshkrimin, ndryshimin dhe zgjidhjen e kontratave të koncesionit, të kontratave të partneritetit publik-privat. Për kontrata të tjera publike për kryerje punimesh, furnizim mallrash dhe furnizim shërbimesh, me vlerë mbi kufirin e ulët monetar, të përcaktuar në legjislacionin në fuqi për prokurimet publike;

b) Për hartimin, negocimin, nënshkrimin, ndryshimin dhe zgjidhjen e kontratave, të cilat parashikojnë zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në arbitrazh ndërkombëtar;

c) Kur shfaqen pretendime nga pala private apo institucioni publik në lidhje me përmbushjen e detyrimeve të kontratës, në rast konflikti interpretimesh apo çdo mosmarrëveshje tjetër në ekzekutimin e kontratave, që parashikojnë zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në arbitrazh ndërkombëtar;

ç) Kur shfaqen pretendime nga investitorë të huaj për shkelje nga Republika e Shqipërisë të ligjit, traktateve apo marrëveshjeve ndërkombëtare për mbrojtjen e investimeve të huaja.

4. Këshillimi i dhënë nga Avokatura e Shtetit personave juridikë, sipas këtij neni, nuk ka karakter detyrues për to, përveç rasteve kur parashikohet si i tillë me ligj.

Neni 20
Kërkesa për këshillim

1. Personat juridikë, sipas kuptimit të ligjit nr. 10 018, datë 13.11.2008, "Për Avokaturën e Shtetit", të ndryshuar, mund t'i drejtojnë Avokaturës së Shtetit kërkesë për këshillim.

2. Organet e njësive të vetëqeverisjes vendore, të cilat kanë marrëveshje të posaçme me Avokaturën e Shtetit, mund t'i drejtojnë Avokaturës së Shtetit kërkesë për këshillim, nëpërmjet kryetarit të tyre.

Neni 21
Procedura e këshillimit

1. Në rastet kur kërkohet këshillim, personat juridikë apo njësitë e vetëqeverisjes vendore paraqesin kërkesë me shkrim, për këtë qëllim, pranë Avokaturës së Shtetit dhe vënë në dispozicion të saj:

a) të gjitha sqarimet, informacionet dhe dokumentacionin që disponojnë për çështjen objekt këshillimi;

b) një vlerësim për rrethanat faktike dhe qëndrim të arsyetuar të çështjes;

c) të dhënat e kontaktit të një personi, për qëllime komunikimi, koordinimi dhe bashkëpunimi me Avokaturën e Shtetit, në kuadër të çështjes objekt këshillimi.

2. Avokatura e Shtetit, gjatë ushtrimit të funksionit këshillues, mund të kërkojë plotësimin e informacionit apo të dokumentacionit të paraqitur apo mund të kërkojë informacione apo

dokumente shtesë, të cilat i gjykon të nevojshme. Personat juridikë detyrohen t'i japin Avokaturës së Shtetit çdo sqarim, informacion apo dokument të kërkuar, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga depozitimi i kërkesës prej kësaj të fundit. Në këtë rast, afati për dhënien e mendimit nga Avokatura e Shtetit llogaritet nga momenti i marrjes së informacionit dhe dokumentacionit shtesë.

3. Avokatura e Shtetit jep mendim për çështjen objekt këshillimi, bazuar mbi aktet dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune, me përjashtim të rasteve kur, për shkak të kompleksitetit të çështjes, është i nevojshëm një afat më i gjatë, përtej afatit fillestar. Në këtë rast, Avokatura e Shtetit njofton personin juridik apo njësinë e vetëqeverisjes vendore, që ka kërkuar këshillimin, duke dhënë motivet për shtyrjen e afatit, si edhe afatin e ri të propozuar.

4. Mendimi i Avokaturës së Shtetit për praktikën këshillimore jepet në çdo rast me shkrim, është konfidencial dhe bëhet pjesë e praktikës për të cilën kërkohet këshillimi.

Neni 22

Shërbimi këshillimor i Avokaturës së Shtetit

1. Avokatura e Shtetit, në mbrojtje të të drejtave dhe të interesave pasurorë të shtetit, bazuar vetëm në një analizë të mirëfilltë juridike të çështjes objekt këshillimi dhe të pasojave juridike, që mund të vijnë prej saj, u jep mendim me shkrim personave juridikë publikë. Në asnjë rast, këshillimi nuk mund të jetë vlerësim mbi qëllimin e nxjerrjes së aktit juridik.

2. Në rastet kur nga ana e personave juridikë kërkohet asistencë juridike për hartimin, negocimin, nënshkrimin, ndryshimin dhe zgjidhjen e kontratave, të parashikuara në nenin 5, të ligjit nr. 10 018, datë 13.11.2008, "Për Avokaturën e Shtetit", të ndryshuar, në këtë rast, Avokatura e Shtetit mund të sugjerojë edhe formulime konkrete të pjesëve të veçanta të kontratës.

3. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit vlerëson, rast pas rasti, kërkesën e personave juridikë për pjesëmarrjen e Avokaturës së Shtetit në negocimin e proceseve të parashikuara në pikën 2 të këtij neni. Asistenca juridike, në çdo rast, jepet në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 10 018, datë 13.11.2008, "Për Avokaturën e Shtetit", të ndryshuar. Gjatë procesit të negocimit të kontratës, Avokatura e Shtetit merr pjesë në cilësinë e konsulentit të personit juridik, duke ofruar asistencë juridike, përveç rasteve kur me urdhër të Kryeministrit, krijohet grup i përbashkët pune dhe Avokatura e Shtetit caktohet si pjesë e grupit të punës për negocimin e kontratës.

4. Mendimi i Avokaturës së Shtetit konsiston kryesisht për të vënë në lëvizje, për të kundërshtuar ose për të tërhequr një çështje në gjykim. Ky mendim mund të jetë edhe sugjerim për procedimet administrative, me natyrë konfliktuale, të cilat mund të bëhen shkak për lindjen e konflikteve gjyqësore.

5. Gjatë ushtrimit të funksionit të këshillimit, Avokatura e Shtetit merr parasysh udhëzimet e dhëna, në çdo rast me shkrim, nga personi juridik, përveç rasteve kur ato bien ndesh me legjislacionin në fuqi ose interesin publik.

Neni 23

Efektet e këshillimit

1. Këshillimi i dhënë nga Avokatura e Shtetit nuk ka karakter detyrues për personin juridik dhe njësitë e vetëqeverisjes, përveç rasteve kur me ligj parashikohet ndryshe.

2. Mendimi këshillimor i dhënë nga Avokatura e Shtetit i drejtohet ekskluzivisht personit juridik që e ka kërkuar dhe në asnjë rast nuk mund të përdoret si provë në gjykim.

3. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, me kërkesë të motivuar të avokatëve ose zyrave të Avokaturës së Shtetit ose kryesisht, bazuar në praktikën e njësuar juridike, për çështje të ngjashme ose të rëndësishme, miraton modele të përgjithshme të këshillimit për avokatët e shtetit.

KREU V
MARRËDHËNIET E AVOKATURËS SË SHTETIT ME PERSONAT JURIDIKË, NË KUADËR TË PËRFAQËSIMIT NË GJYKATAT E HUAJA, NDËRKOMBËTARE DHE NË ARBITRAZHIN NDËRKOMBËTAR

Neni 24
Përfaqësimi në gjykatat e huaja, ndërkombëtare dhe në arbitrazhin ndërkombëtar

1. Avokatura e Shtetit është institucioni i ngarkuar ekskluzivisht për dhënien e asistencës juridike, në formën e përfaqësimit dhe mbrojtjes së interesave të shtetit shqiptar pranë gjykatave të huaja, organizmave ndërkombëtare, me karakter gjyqësor apo mbikëqyrës.
2. Përfaqësimi dhe mbrojtja e interesave të shtetit shqiptar pranë gjykatave të huaja dhe organizmave ndërkombëtarë, me karakter gjyqësor apo mbikëqyrës, kryhen nga Avokatura e Shtetit, nëpërmjet zyrës së përfaqësimit në gjykatat e huaja, ndërkombëtare dhe në arbitrazhin ndërkombëtar.

Seksioni 1

Neni 25
Përfaqësimi në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut

1. Përfaqësimi dhe mbrojtja e interesave të shtetit shqiptar në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut realizohet nga Avokatura e Shtetit, nëpërmjet agjentit qeveritar ose bashkagjentëve.
2. Agjenti qeveritar ose bashkagjenti, në funksion të realizimit të përfaqësimit në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, kërkon informacion për faktet dhe rrethanat apo dokumentacion nga personat juridikë, të përfshirë apo që kanë të dhëna për çështjen në shqyrtim.
3. Personi juridik është i detyruar që të vendosë në dispozicion informacionin e kërkuar brenda 5 (pesë) ditëve pune nga marrja e kërkesës.

Neni 26
Ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

1. Kur vendimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut merr formë të prerë, Avokatura e Shtetit kërkon nga personi juridik përgjegjës për ekzekutimin e vendimit një plan për masat që do të ndërmarrë për ekzekutimin e tij, si dhe informacion për afatin dhe mënyrën e ekzekutimit. Personi juridik është i detyruar t'i përgjigjet kërkesës së Avokaturës së Shtetit brenda 20 (njëzet) ditëve punë nga komunikimi i saj.
2. Personi juridik përgjegjës informon çdo 3 (tre) muaj Avokaturën e Shtetit për masat e ndërmarra, në kuadër të ekzekutimit të vendimit, dhe menjëherë në rastet kur konstaton pengesa në ekzekutimin e tij. Informimi periodik do të vijojë deri kur Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës të mbyllë, me rezolutë përfundimtare, monitorimin e procesit të ekzekutimit të vendimit.
3. Në rastet kur ekzekutimi i vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka vështirësi për t'u zbatuar, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, në rolin e tij si agjent qeveritar, kërkon një vlerësim të situatës edhe nga Këshilli Konsultativ i Çështjeve në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Vlerësimi i Këshillit Konsultativ u përcillet personave juridikë përgjegjës për ekzekutimin e vendimit.
4. Avokatura e Shtetit njofton Këshillin e Ministrave, në rastet kur konstaton se nga personat juridikë nuk po merren masat e duhura për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut apo ka vështirësi në ekzekutimin e tij. Në rastet kur përgjegjës për ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut janë organet publike të pavarura apo të gjyqësorit, Avokatura e Shtetit njofton organet eprore të tyre.

Seksioni 2
Marrëdhëniet me institucionet, në kuadër të bashkëpunimit për përfaqësim në arbitrazhin ndërkombëtar

Neni 27
Njoftimi i mosmarrëveshjes objekt arbitrazhi

1. Në rastet kur personi juridik apo autoriteti përkatës shtetëror merr një kërkesë për arbitrazh apo një njoftim të barasvlershëm me të, ia përcjell menjëherë atë Avokaturës së Shtetit bashkë me dokumentacionin dhe provat shoqëruese.

2. Personi juridik është i detyruar t'u sigurojë informacionin dhe bazën dokumentare të nevojshme, që lidhet me çështjen e arbitrazhit, jo më vonë se 5 (pesë) ditë punë nga marrja e kërkesës së Avokaturës së Shtetit, përkatësisht:

a) të gjithë dokumentacionin e dërguar nga pala kundërshtare apo sekretariati i forumit përkatës të arbitrazhit apo gjykatat e juridiksioneve të ndryshme;

b) të gjithë informacionin dhe dokumentacionin, që zotëron për çështjen në fjalë;

c) një historik të çështjes, objekt i mosmarrëveshjes në arbitrazh;

ç) një vlerësim të brendshëm institucional për rrethanat faktike; dhe të gjitha pretendimet e parashtruara nga pala kundërshtare dhe kundërpretendimet e personit juridik;

d) konfirmim për mundësinë e ushtrimit të së drejtës së kundërpadisë;

dh) informacion për çdo element tjetër të çështjes, sikundër mund të rezultojë e nevojshme, rast pas rasti;

e) të dhënat e kontaktit të personit të caktuar, për qëllime komunikimi, koordinimi dhe bashkëpunimi me Avokaturën e Shtetit, në kuadër të përfaqësimit dhe mbrojtjes së çështjes. Në rast se është e mundur, personi i kontaktit të institucionit të interesuar të jetë një person që ka njohuri të thelluara për mosmarrëveshjet e pretenduara dhe dokumentacionin përkatës;

ë) konfirmim zyrtar, që informacioni apo dokumentacioni që i është përcjellë Avokaturës së Shtetit është i plotë dhe shterues dhe se personi juridik në fjalë nuk zotëron asnjë informacion ose dokumentacion tjetër për çështjen objekt mosmarrëveshjeje.

3. Personat juridikë, që janë thirrur si të paditur në një proces arbitrazhi ndërkombëtar dhe vlerësojnë mundësinë e paraqitjes së një kundërpadie në atë proces arbitrazhi, duhet të njoftojnë menjëherë Avokaturën e Shtetit për këtë të fundit, duke i siguruar njëherazi një vlerësim ligjor, teknik dhe financiar për paraqitjen e kësaj kundërpadie, si dhe gjithë dokumentacionin mbështetës në këtë rast.

Neni 28
Krijimi i grupeve të përbashkëta në përfaqësim

1. Në raste specifike, kur çështja paraqet kompleksitet, mbi bazën e një kërkese të paraqitur nga Avokatura e Shtetit, personat juridikë caktojnë një ose disa përfaqësues, të cilët sipas specialitetit apo fushës së tyre të ekspertizës, do të bashkëpunojnë me Avokaturën e Shtetit, duke u përfshirë por pa u kufizuar, në cilësinë e dëshmitarit, ekspertit, në realizimin e mbrojtjes dhe përfaqësimit të personit juridik të interesuar në një proces arbitrazhi ndërkombëtar.

2. Në çdo rast, strategjitë për përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të personit juridik të interesuar, do të përcaktohen nga Avokatura e Shtetit dhe/ose avokatët ose studiot e avokatisë të kontraktuara për këtë qëllim.

Neni 29
Sigurimi i informacionit

1. Personi juridik i interesuar është i detyruar t'i sigurojë Avokaturës së Shtetit, jo më vonë se 5 (pesë) ditë punë informacionin, si dhe bazën dokumentare të nevojshme që lidhet me çështje të përfaqësimit në arbitrazh nga marrja e kërkesës prej Avokaturës së Shtetit.

2. Personi juridik i interesuar është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave për sqarim të Avokaturës së Shtetit mbi informacionin dhe bazën dokumentare të siguruar prej tij, jo më vonë se 5 (pesë) ditë punë nga marrja e kërkesës prej Avokaturës së Shtetit.

3. Informacioni dhe dokumentacioni i siguruar nga personi juridik i përfaqësuar duhet të jetë i qartë, i saktë dhe sa më shterues për të gjitha elementet, që kanë rëndësi dhe lidhen me çështjen konkrete të arbitrazhit.

Neni 30
Konfidencialiteti

1. Komunikimi midis Avokaturës së Shtetit dhe personit juridik, në lidhje me asistencën për përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të personit juridik përkatës në gjykatat e huaja ndërkombëtare dhe arbitrazhin ndërkombëtar, i nënshtrohet parimit të konfidencialitetit.

2. Për çështjet e arbitrazhit në gjykim apo para gjykatave të huaja, e drejta për informim i nënshtrohet parimit të konfidencialitetit.

KREU VI
MARRËDHËNIET E AVOKATURËS SË SHTETIT ME INSTITUCIONE TË VEÇANTA NË NDIHMË TË OFRIMIT TË ASISTENCËS JURIDIKE

Neni 31
Marrëdhëniet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës

1. Agjencia Shtetërore e Kadastrës ofron shërbimin si person juridik, në kuadër të dhënies së informacionit dhe bashkëpunimit me Avokaturën e Shtetit.

2. Agjencia Shtetërore e Kadastrës përgjigjet brenda afateve të arsyeshme për të gjitha kërkesat e drejtuara nga Avokatura e Shtetit, në kuadër të marrjes së informacionit për përfaqësimin e çështjeve gjyqësore. Agjencia Shtetërore e Kadastrës kryen regjistrimin, brenda afateve të parashikuara në nenin 29, të ligjit nr. 111/2018, "Për kadastrën", nga momenti i paraqitjes së kërkesës nga Avokatura e Shtetit për të gjitha aktet e parashikuara në nenin 193, të Kodit Civil.

3. Për rastet kur, Avokati i Shtetit gjykon se afatet janë të ngutshme, apo nga vonesa mund të shkaktohen pasoja negative ndaj interesave pasurorë të shtetit, i kërkon Agjencisë Shtetërore të Kadastrës ose drejtorisë vendore, reagimin e shpejtë dhe kthimin e shpejtë të përgjigjes, duke cilësuar shkresën "urgjente".

4. Për çdo shërbim, që i ofrohet Avokaturës së Shtetit nga ana e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, lëshohet faturë ndaj personit juridik për interes të të cilit është kërkuar shërbimi. Të gjitha shërbimet që i ofrohen Avokaturës së Shtetit nuk parapaguhen.

5. Kur konstatohet mungesë bashkëpunimi nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe drejtoritë vendore, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit njofton titullarin e institucionit dhe Kryeministrin, sipas nenit 5 të kësaj rregulloreje.

Neni 32
Marrëdhëniet me personat juridikë pranë të cilëve ka ekspertë me njohuri të specializuara

1. Çdo institucion shtetëror ose ent publik, që ka në organikën e tij ose të institucioneve në varësi, specialistë të fushave apo shërbime për dhënie të mendimeve të specializuara, ka detyrimin që të ofrojë bashkëpunimin me Avokaturën e Shtetit, në rast se një gjë e tillë i kërkohet nga avokatët e shtetit, në kuadër të përfaqësimit në gjykim.

2. Për rastet kur, avokatët e shtetit kërkojnë bashkëpunim në kuadër të dhënies së një mendimi të specializuar, nëpërmjet vlerësimit, trajtimit dhe dhënies së mendimit, në funksion të realizimit të përfaqësimit ligjor, personat juridikë duhet të garantojnë ofrimin e këtij bashkëpunimi dhe realizimin e kërkesave të avokatëve të shtetit.

3. Kërkesa për bashkëpunim paraqitet nga avokati i shtetit dhe, sipas rastit, përmban kërkimet konkrete, fushën specifike për të cilën kërkohet mendimi ose vlerësimi i specializuar, dokumentacioni shoqërues dhe afati, brenda të cilit duhet kthyer përgjigjja.

4. Mospërmbushja e detyrimeve, sipas kësaj dispozite, përbën shkak për të njoftuar titullarin e institucionit dhe Kryeministrin, sipas nenit 5, e vijues të kësaj rregulloreje.

5. Në rastet kur, shërbimi i kërkuar përmban shpenzime apo tarifa të parashikuara shprehimisht në ligj, efektet financiare faturohen ndaj personit juridik, për llogari të të cilit Avokatura e Shtetit kryen përfaqësimin.

KREU VII
SHPENZIMET E PROCESIT

Neni 33
Tarifat gjyqësore, depozitat, garancitë

1. Avokatura e Shtetit përjashtohet nga detyrimi për pagimin e tarifave gjyqësore, shpenzimeve gjyqësore, si dhe tarifave për veprimet që kryhen nga personat juridikë publikë, administrata gjyqësore, prokuroria, shërbimi përmbarimor gjyqësor shtetëror dhe personat juridikë, me kapital shtetëror.

2. Shpenzimet gjyqësore apo të noterisë, të nevojshme gjatë dhënies së asistencës juridike, kur nuk plotësojnë kriteret e pikës 1, të këtij neni, paguhen nga personi juridik palë në proces apo i interesuar.

3. Në rastet kur për efekte të mbrojtjes së interesave të shtetit në gjykim kërkohet krijimi i depozitave, garancive apo pagesave të ngjashme, shpenzimet për këtë qëllim mbulohen nga buxheti i personit juridik të interesuar.

Neni 34
Shpenzimet në kuadër të proceseve në gjykatat e huaja, ndërkombëtare, arbitrazhin ndërkombëtar

1. Pagesat, në kuadër të gjykimeve në gjykatat e huaja, ndërkombëtare, arbitrazhin ndërkombëtar, të tilla si pagesat për shpenzimet gjyqësore, shpenzimet administrative dhe logjistike, duke përfshirë, por pa u kufizuar në tarifa regjistrimi, pagesat e arbitrave, ekspertëve të caktuar drejtpërdrejt nga gjykata, dëshmitarëve, përkthimit të akteve dhe përkthimit me gojë, pagesat e transkriptimit dhe çdo shpenzim tjetër, në funksion të procesit, duhet të kryhen nga ana e personit juridik të interesuar.

2. Shpenzimet e realizuara lidhur me kontraktimin e avokatëve/studiove të avokatisë, si dhe ekspertëve të kontraktuar nga pala shqiptare për nevoja të procesit, rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU VIII
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 35

Brenda 30 ditëve kalendarike nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të gjithë personat juridikë duhet t'i njoftojnë Avokaturës së Shtetit të dhënat e plota të personit të kontaktit, sipas nenit 5 të kësaj rregulloreje.